



Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Kosovë

RrGGK Organizon Aktivitet Avokues në Rrugë në Kuadër të Forumit Rajonal të Feministeve të Reja 2013

Sot u zhvillua dita e parë e FORUMIT Rajonal të Feministeve të Reja 2013 të organizuar nga Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK). Ky forum, i cili po fokusohet tek ndikimi që kanë vajzat për çështjet aktuale vendore dhe globale, do të vazhdojë edhe gjatë ditës së nesërme.

Me 14 Nëntor në ora 15:00 -16:00, RrGGK ka planifikuar një aktivitet avokues në rrugë me temën: “Diskriminimi në punë – Ngritja në pozitë”. Kjo do të jetë një mundësi për të gjitha vajzat të shohin se si planifikohet dhe organizohet një aktivitet i tillë. Ky aktivitet përfshinë një performancë të përgaditur nga vajzat pjesëmarrëse në Forum, në bashkëpunim me Artpolis dhe do të mbahet para Teatrit Kombëtar, në Sheshin Nëna Terezë.

RrGGK fton të gjithë qytetarët që të na bashkangjiten dhe ta përkrahin këtë aktivitet avokues në rrugë.

Forumi Rajonal i Feministeve të Reja 2013 është përkrahur nga Kvinna till Kvinna (KtK).

Rrjetit i Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK) është të përkrahë, mbrojë dhe promovojë të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave anëmbanë Kosovës, pa marrë parasysh bindjet e tyre politike, religjionin, moshën, nivelin e arsimimit, orientimin seksual apo aftësitë e kufizuara. RrGGK përmbush misionin e vet përmes këmbimit të përvojave dhe informatave, partneriteteve dhe rrjetëzimit, hulumtimeve, avokimit dhe ofrimit të shërbimeve. Si Rrjeti i 71 organizatave të grave nga të gjitha grupet etnike në tërë Kosovën, RrGGK avokon në emër të grave kosovare në nivel lokal, rajonal dhe ndërkombëtar.